

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga **BOREALIS AG** me seli në Trabren 6-8, 1020 Vjenë, Austri, përmes avokates Andrea Lazarevska, nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 15.01.2024, mori këtë

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin **BOREALIS AG** me seli në Trabren 6-8, 1020 Vjenë, Austri synon të fitoj kontroll të drejtpërdrejtë të vetëm mbi **INTEGRA PLASTIKS AD**, me seli në rr. Asen Jordanov nr. 60, Rrethi Lozents, Sofje 1407, Bullgari, me anë të blerjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 14.12.2023, ndërsa e plotësuar më 22.12.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim i përqendrimit nga **BOREALIS AG** me seli në Trabren 6-8, 1020 Vjenë, me anë të cilit **BOREALIS AG** synon të fitoj kontroll të drejtpërdrejtë të vetëm mbi **INTEGRA PLASTIKS AD**, me seli në rr. Asen Jordanov nr. 60, Rrethi Lozents, Sofje 1407, Bullgari, me anë të blerjes së aksioneve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

BOREALIS AG është një shoqëri publike me përgjegjësi të kufizuar që operon në mbi 120 vende dhe punëson rreth 6000 njerëz.

Borealis AG është një nga furnizuesit kryesorë në botë të solucioneve poliolefine të avancuara dhe të qëndrueshme dhe aktivitetet e tyre tregtare janë të përqendruara rreth prodhimit dhe shpërndarjes së solucioneve të avancuara dhe rrethore të poliolefinave dhe kimikateve bazë.

Në Evropë, Borealis AG është gjithashtu një lider inovativ në riciklimin e poliolefinave dhe një prodhues kryesor kimikateve bazë. Borealis AG kontrollohet përfundimisht nga OMV. OMV është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar publike e themeluar sipas ligjeve të Austrisë, e cila është e listuar publikisht në bursën austriake.

Grupi OMV është një grup ndërkombëtar i integruar i naftës, gazit dhe kimikateve, aktiv në mbarë botën në tre segmentet e mëposhtme të biznesit që mbulojnë zinxhirin e vlerës së hidrokarbureve.

OMV nuk ka shoqëri të varura apo filiale në Maqedoninë e Veriut. Grupi OMV/Grupi Borealis arriti qarkullim në Maqedoninë e Veriut përmes shitjes së poliolefinave (p.sh. polipropileni dhe polietileni) dhe komponimeve të polietilenit.

INTEGRA PLASTIKS AD është një kompani bullgare kryesisht aktive në fushën e riciklimit të poliolefinave dhe e specializuar në prodhimin e polietilenit me densitet të ulët.

Integra Plastiks nuk është aktive në Maqedoninë e Veriut, as nuk ka ndërmarrje-bijë, filiale, apo përfaqësi në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски